



## Mbrojtja e të drejtës së autorit në Bashkimin Europian

MSc. Hyri Rama, MSc. Ines Tërshalla, MSc. Jonida Caushi

### Abstract

Copyright is built on the basis of the legal system as the fundamental right to protect the artistic, cultural and economic rights that these inherent rights derive from the originality and creative spirit of each person who has the talent to create great works, distinction from industrial property that protects the rights to inventions, various innovative ideas from the industrial and technical-technological world. The democratic countries of the world have realized the protection of these rights, as the right to creative expression derived from the mind and the artistic spirit. Copyright is a relatively new legal institute compared with well-known and regulated institutions since Roman law. The development of modern copyright legislation relied on legal efforts that were constrained by trade interests to take control of the monopoly of publishing industry and manufacturing law. In addition to publishers' interest in having monopoly on book production, the development of copyright was influenced by many of those forces who were interested in the intention to control the contents of new authorship works. It can not be said that there has never been any objection regarding the copyright protection limits due to the type of work created. For example, in the beginning, the protection of copyright has extended to literary writings. It has always been an early point of debate if the authorship is characteristic of literary works or of any kind of work. This debate resolved quickly when one of the first copyright laws gave protection to fine art works as well. When it became clear that literature and especially the art of writing was not the last limit of copyright and that the writings "could include paintings, sculptures and other works of art, was given a great boost to authorship relations . It has also become clear that "authors" can mean not only artists who write and may not only be writers, but may not be artists as well.

### Abstrakt

E drejta e autorit është ndërtuar mbi bazat e sistemit juridik si e drejtë themelore që mbron të drejtat artistike, kulturore dhe ekonomike, të drejta këto, që rrjedhin nga origjinaliteti dhe shpirti krijues i secilit njeri që ka talent për të krijuar vepra të mëdha, për dallim nga pronësia

industriale e cila mbron të drejtat mbi shpikjet, idetë e ndryshme inovative nga bota industriale dhe tekniko-teknologjike. Vendet demokratike të botës, kanë realizuar mbrojtjen e këtyre të drejtave, si të drejta të shprehjes kreative që burojnë nga mendja dhe shpirti artistik. E drejta e autorit është një institut juridik relativisht i ri krahasuar me institutet enjohura dhe të rregulluara që nga e drejta romake. Zhvillimi i legjislacionit modern mbi të drejtën e autorit u mbështet në përpjekjet ligjore që u kushtëzuan nga interesat tregtare për të marrë kontrollin e monopolit të industrisë botuese dhe të së drejtës prodhuese. Përveç interesit të botuesve për të patur monopolin për prodhimin e librave, zhvillimi i së drejtës së autorit u ndikua shumë nga ato forca që ishin të interesuara nga synimi për të patur nën kontroll përmbytjen e veprave të reja të autorësisë. Nuk mund të thuhet se nuk ka patur asnjëherë kundërshtime lidhur me kufijtë e mbrojtjes të së drejtës së autorit për shkak të llojit të veprës së krijuar. Për shembull, në fillim mbrojtja e të drejtës së autorit është shtrirë më shumë tek shkrimet letrare. Gjithmonë ka qënë një pikë e hershme debati nëse autorësia është karakteristike e veprave letrare apo e çdo lloji vepre. Ky debat u zgjidh shpejt kur, një nga statutet epara të së drejtës së autorit dha mbrojtjen edhe për veprat e arteve të bukura. Kur u bë e qartë se letërsia dhe veçanërisht arti i të shkruarit nuk ishte limiti i fundit për të drejtën e autorit dhe se shkrimet mund të përfshinin edhe piktura, skulptura dhe punime të tjera arti, iu dha një shtysë e madhe dhe marrëdhëniet të autorësisë. Gjithashtu, u bë e qarte se „autore“ mund të nënkuptojme, jo vetëm artistet që shkruajnë, dhe jo vetëm mund të mos jenë shkrimtarë, por mund të mos jenë edhe artistë.

**Fjalë kyçe:** sistem juridik, e drejtë, pronësi intelektuale, interes, debat.

\* \* \*

### 1. Nocioni Pronësisë Intelektuale

Pronësia Intelektuale (PI) i referohet krijimeve mendore: shpikjeve, veprave letrare dhe artistike, simboleve, emrave, imazheve, dizajneve të përdorura në afarizëm<sup>1</sup>. Titullarët e këtyre të drejtave mund t'i ndalojnë të tjerët

<sup>1</sup> Organizata Botërore për Pronësi Intelektuale (WIPO): <http://www.wipo.int/about-ip/en/>



që t'i përdorin krijimet e tyre pa autorizim paraprak, ose mund të lejojnë shfrytëzimin dhe përdorimin e tyre në shkëmbim të kompensimit material për përpjekjet dhe investimet e tyre gjate gjithë krijimtarisë. Pronësia intelektuale ndahet në dy degë, "pronësinë industriale" dhe "të drejtën e autorit". Për qëllime të kësaj Strategjie, çdo referencë tek Pronësia Intelektuale duhet të nënkuptohet se bëhet fjalë edhe për pronësinë industriale edhe për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta. Pronësia Industriale përfshinë të drejtën lidhur me Patentat, dizajnet industrial, markat tregtare dhe markat e shërbimeve, emrat tregtarë, indikacionet (treguesit) gjeografike, varietetet e reja bimore, tipografite e qarqeve të integruara, dhe mbrojtjen nga konkurrenca e padrejtë. Të drejtat e autorit janë të drejta që u njihen personave të caktuar për krijimtarinë e tyre në fushën e letërsisë, shkencës dhe artit dhe përfshijnë në mes tjerash: romanet, poezitë, kompozimet muzikore, skulpturat, pikturat, vizatimet, krijimet kinematografike, arkitekturën, koreografinë, fotografimin dhe krijimet tjera të ngjashme. Kjo degë e Pronësisë Intelektuale përfshinë edhe të ashtuquajtura të drejta të tjera të përafërta me të drejtën e autorit; e drejta e artistëve interpretues (këngëtarët, muzikantët tjerë, valltarët, aktorët dhe të tjerët të cilët interpretojnë vepra); producentët e fonogrameve, producentët e filmave dhe organizatat transmetuese.

### 1.1 E drejta e autorit në planin ndërkombëtar

Mbrojtja e së drejtës së autorit është bërë disa herë objekt rregullimesh dhedebatesh edhe në planin ndërkombëtar. Krahas Konventave specifike, për të drejtën e autorit, janë realizuar dhe traktate me përmbajtje mjaft të gjërë e të ndryshme, në të cilat janë përfshirë klauzola të vecanta, që i atribuohen të drejtës së autorit. E drejta e autorit trajtohet edhe në doktrinën, e cila merr në mbrojtje të drejtat

themelore të njeriut. Në të gjitha materialet e përmendura, është vënë theksi në rregullimin juridik të kësaj fushe, mjaft të rëndësishme. Vlen të përmendet Deklarata e Drejtave të Njeriut dhe të Qytetarit, e cila konsiderohet si një dokument i rëndësishëm ndërkombëtar, i përfshirë pas Luftës së Dytë Botërore, e deklaruar me 1 Dhjetor 1948, nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe e miratuar nga 48 shtete të ndryshme të botës anëtare të hershme të OKB-së.

Kjo deklaratë e përgjithshme nuk formon vetëm një lloj besimi kolektiv, në vlerat supreme të personit njerëzor, por në planin juridik formon një lloj baze për të përcaktuar të drejtat, të cilat më parë ishin konsideruar, më tepër, objekt i ligjit moral. Në nenin 27 të kësaj Deklarate, thuhet: "E drejta për të marrë pjesë lirish në jetënkulturore, të komunitetit njerëzor, për të gëzuar nga ato dhe pjesëmarrja, në progresin shkencor apo të të mirave, që rrjedhin prej tyre, janë të drejta të pamohueshme të njeriut, të cialt garantohej dhe mbrohen nga qeveritë e shteteve aderuese, në këtë deklaratë të përgjithshme". Konventa për mbrojtjen dhe respektimin e të Drejtave të Njeriut e 15 vendeve të ndryshme të Botës, që hyri në fuqi në vitin 1953, ka qënë një instrument i rëndësishëm, që sanksiononte

të drejtat analoge më të përcaktuara nga Deklarata e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut e të Qytetarit e OKB-së. Në përmbajtjen e normave të kësaj Konvente, parashikohet themelimi i dy instituteve të rëndësishme ndërkombëtare, të cilët kishin detyrë, sigurimin e ushtrimit të të drejtave të mësipërme, ndaj shtetasve, që shkëlqin këto duke u parashikuar edhe gjykata kompetente, e cila do të shqyrtonte çështjet, që mund të lindnin në kuadrin eshkeljeve të këtyre të drejtave të rëndësishme të Njeriut, ku përfshihej edhe e Drejta e Autorit. Me rëndësi, për mbrojtjen e të Drejtës së Autorit, ka qënë edhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Pasurore e Shoqërore, si dhe Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike nënshkruar në vitin 1966. Neni 15 parashikon mundësinë e mbrojtjes nga ana juridike të së Drejtës së Autorit. Konventa e Bernës për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike është themeli i mbrojtjes ndërkombëtare të veprave. Ajo lejon që një autor të ketë të drejta dhe mbrojtje nga çdo vend në të cilin i botohet vepra. Konventa është nënshkruar në Bernë në 09.09.1886 dhe ka pësuar disa ndryshime e modifikime. Modifikimi i fundit i është bërë në Paris në 1979. Kjo konventë është nënshkruar nga 164 shtete, ndërkohë që vetë Organizata Botërore e Pasurisë Intelektuale ka 184 anëtarë. Kjo konventë përmban tre parime bazë mbi të cilët ajo ushtron veprimtarinë e saj. Veprat e një autori të kësaj lidhjeje duhet të mbrohen në mënyrë të njëjtë nga çdo shtet nënshkruar. Ajo mbron shumë autoritë dhe ata që përfitojnë mbrojtje të dobët nga shteti i tyre i origjinës, me kusht që të kenë botuar qoftë një herë në tregun e Bashkimit Europian.<sup>2</sup>

Kjo mbrojtje nuk ka nevojë për asnjë lloj formaliteti, sepse ajo është automatike. Ajo është gjithashtu e pavarur nga ekzistenca e mbrojtjes në vendin e origjinës së veprës. Konventa e Bernës mbron çfarëdolloj veprave letrare e artistike të çdolloj forme qoftë ajo. Mbrojtja e të drejtave sipas kësaj konvente ka një kohëzgjatje prej 50 vjetësh pas vdekjes së autorit.

### 1.2 E drejta e autorit sipas legjislacionit të BE-së

Sipas të drejtës së Bashkimit europian, rregullimi normativ i të drejtës së autorit, si proces, u ndërmor me qëllim harmonizimit e ligjeve të ndryshme kombëtare të Shteteve anëtare, të cilët erregullonin në mënyra të ndryshme këtë të drejtë. Një iniciativë për harmonizimin ekuadrit ligjor në këtë fushë, nga ana e Bashkimit europian, u ndërmor kryesisht përdisa arsye:

Së pari e drejta e autorit është pjesë përbërëse e të drejtës së pronësisë intelektuale, e cila është vlerësuar si e një rëndësie të madhe në Bashkimin Europian, në kuadër të rregullimit normativ të shtyllës së parë të Bashkimit Europian. Kështu qërregullimi i të drejtës së autorit në kuadër të rregullimit të së drejtës së pronësisë intelektuale ishte i pashmangshëm për Bashkimin Europian.

Së dyti shtetet anëtare e kishin rregulluar këtë të drejtë me norma juridike kombëtare, përpara hyrjes në fuqi të traktateve të Komunitetit europian e më pas edhe të traktateve për krijimin e modifikimin të Bashkimit Europian, dhe shtetet anëtare prezantoheshin me

<sup>2</sup> Konventa e Bernës për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike, Bernë, 1886.



legjislacione të ndryshme në këtë fushë. Kuadri ligjor kombëtar i Shteteve anëtare në këtë fushë, për më tepër, ishte ngritur në nivel ndërkombëtar nëpërmjet traktateve ndërkombëtare<sup>3</sup>, të nënshkruara prej tyre, përpara anëtarësimit të tyre në Komunitet e Bashkim Europian.

Së treti, e drejta e Bashkimit europian ka prioritet (supremaci) mbi të drejtën e Shteteve anetare, ç'ka conte ne konflikt ndërmjet detyrimeve të mara nga ana e Shteteve në kuadër të traktateve ndërkombëtare me ato të ndërmara në kuadër të Komunitetit dhe Bashkimit europian.

Harmonizimi i legjislacionit gjet si një zgjidhje e cila do të ruante ekuilibrat e detyrimeve të ndërmara nga Shtetet anëtare në rang ndërkombëtar me ato të ndërmara në rang europian. Në këtë proces harmonizimi të kuadrit normativ të Bashkimit Europian në fushën e të drejtës së autorit, përveç traktateve ndërkombëtare kane aderuar Shtetet anetare, dy "produkte" terëndësishme institucionale kanë lënë gjurmë: Direktivat dhe Vendimet e Gjykatës së Drejtësisë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë.<sup>4</sup> Komuniteti i Bashkimi Europian, në fushën e të drejtës së autorit, ka „prodhuar“ një numër të caktuar direktivash. Direktivat janë akte institucionale të detyrueshme për shtetet anëtare.<sup>5</sup> Kjo nënkupton që direktivat në fushën e të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të, të „prodhuara“ në gjirin e Bashkimit europian, janë „perthithur“ nga Shtetet anetare në legjislacionin e tyre të brendshëm nëpërmjet procedurës së transportimit, duke ndikuar në përmbajtjen e legjislacioneve kombëtare të këtyre shteteve drejt arritjes së standardeve të përbashkëta të ofruara nga direktivat. Direktivat e Bashkimit europian në fushën e të drejtës së autorit kanë çuar, drejt modifikimit të legjislacioneve kombëtare mbi rregullimin dhe mbrojtjen ekësaj të drejte. Direktivat e Bashkimit Europian në fushën e të drejtës së autorit janë të shumta ndër të cilat mund të përmendim: fillimisht direktivat e para të ndërmara në kuadër të Komunitetit Ekonomik Europian (KEE) janë: direktiva 91/250 e KEE, “Mbrojtjen ligjore të programeve kompjuterike” e vitit 1991 e pasuar nga direktiva 93/98 e KEE, “Mbrojtjen e mbrojtjes së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të”, e vitit 1993. Me pas një numër i madh direktivash që dolën, pas uran rregullimit normativ të të drejtës së autorit, në kuadër të shfaqjes së ndershme të tyre edhe të të drejtave të lidhura me to. Për sa i përket të drejtës së autorit, legjislacioni ekzistues i referohet dispozitave ligjore europiane (Acquis të BE'se) temëposhtme:

-Direktiva 93/83/KEE date 27 shtator 1993 “Për koordinimin e rregullave për të drejtën e autorit dhe të drejtave të lidhura me të që zbatohen në transmetimet satelitore dhe ritransmetimet kabllorë.

<sup>3</sup> Berne Convention for the Protection of Literary and Artistic Works (Paris 1971), TRIPS-(Trade Related Intellectual Property Rights) on WTO, WIPO-Performances and Phonograms Treaty (WPPT-1996).

<sup>4</sup> Borchardt.K.D, 2011, ABC e së Drejtës së Bashkimit Europian, Pegi, Tiranë, fq 92-96.

<sup>5</sup> Neni 249 §3 i TKE (traktat i konsoliduar).

-Direktiva 2001/84/KE e Parlamentit Europian dhe Këshillit date 27 shtator 2001 “Për të drejtën e rishitjes në dobi të autorit të një vepre arti origjinale”.

-Direktiva 2006/115/KE e Parlamentit Europian dhe Këshillit datë 12 dhjetor 2006

“Për të drejtën e qirase dhe huazimit si dhe për disa të drejta që lidhen me të drejtën e autorit në fushën e pronësive intelektuale” (version i kodifikuar i 92/100/KEE).

-Direktiva 2006/116/KEE e Parlamentit Europian dhe Këshillit datë 12 dhjetor 2006

“Për mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me të” (version i

kodifikuar i 93/98/KE). Kjo direktive ka hyrë në fuqi në 16.01.2007. Ajo ka për qëllim mbrojtjen e të drejtave të autorit 70 vjet pas vdekjes së tij, apo pas vdekjes së autorit dhe bashkautorëve të tjerë. Në rast të kundërt, nga data kur vepra është bërë ligjërishme e aksesueshme për publikun nëse kemi të bëjmë me një vepër anonime. Përsa i përket të drejtave të tjera të lidhura me të, ato kanë një kohëzgjatje prej 50 vjet nga data e ekzekutimit. Kjo direktivë parashikon që periudha e mbrojtjes fillon simultanisht në të gjithë shtetet e Bashkimit Europian duke nisur nga data 1 janar e vitit që vijon. Nëse autori i përket një shteti jashtë Bashkimit Europian, atëherë kjo mbrojtje mbaron sipas parashikimeve të legjislacionit të brendshëm.

-Direktiva 96/9/KE e Parlamentit Europian dhe Këshillit date 11 mars 1996 “Për mbrojtjen ligjore të bazave të të dhënave”.

-Direktiva 2009/24/KE e Parlamentit Europian dhe Këshillit date 23 prill 2009 “Për mbrojtjen ligjore të programeve kompjuterike”.<sup>6</sup>

## 2. Jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë mbi të Drejtën e Autorit.

Gjykata europiane e drejtësisë siguron respektimin dhe interpretimin uniform të së drejtës komunitare. Ajo është kompetente për të zgjidhur mosmarrëveshjet për shkak të së drejtës së BE palë të të cilave mund të jenë shtetet anëtare, institucionet e BE-së, ndërmarrjet dhe individët. Misioni i Gjykatës së Drejtësisë është të sigurojë respektimin e së drejtës në dy fusha: në atë të interpretimit dhe të aplikimit të traktateve. Në cilësinë e saj si një institucion juridiksional i Bashkimit Europian ajo eviton që çdo juridiksion shtetëror të interpretojë dhe të aplikojë të drejtën komunitare sipas mënyrës së tij.

Përsa i përket “produktit” të dyte që ka lene gjurme në atë pjesë të të drejtës së Bashkimit Europian që rregullon të drejtën e autorit, e konkretisht jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë dhe ajo e Gjykatës së Shkallës së Parë, mund të themi se kjo kasjellur një evoluim pozitiv në këtë fushë. Theksojmë se jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Europian nuk është burim i së drejtës së Bashkimit europian, edhe në rastet me objekt të drejtën e autorit. Ajo ka sherbyer në „zbulimin e qëllimit të direktives“, në rastet kur ajo është investuar

<sup>6</sup>[http://europa.eu/legislation\\_summaries/internal\\_market/businesses/intellectual\\_property/126032\\_fr.html](http://europa.eu/legislation_summaries/internal_market/businesses/intellectual_property/126032_fr.html)



per te „interpretuar“ apo „aplikuar“<sup>7</sup>aktet normative në fushën e të drejtës së autorit. Shkaqet për të cilat është investuar Gjykata e drejtësisë në fushën e të drejtave të autorit, janë të ndryshme, por ndër më kryesoret janë ato të mostranspportimit në kohë të direktivave nga Shtetet anëtare apo, ato për shkak të egzistencës së normave juridike kombëtare me natyrë diskriminuese. Një aspekt tjetër i kontributit të jurisprudencës së Gjykatës së Drejtësisë, në sqarimin e legjislacionit në fushën e rregullimit dhe mbrojtjes së të drejtës së autorit, është edhe ai i punës së gjykatës në zhdukjen e normave diskriminuese për shkak të shtetësisë si dhe zhdukja e monopoleve të tregut të ndërtuara me ligj në fushën e të drejtës së autorit<sup>8</sup>.

Me interes dhe mjaft të njohura janë edhe vendimet e Gjykatave të common-law, në mënyrën se si ato trajtojnë elementë të të drejtës së autorit. E tillë është çështja Gordon kundër Nextel Communication, në të cilën trajtohet (de minimis use), ku gjykata e apelit vendosi se një përdorim shumë i shkurtër i ilustrimeve me të drejtë autori në një reklamë televizive ishte një përdorim de minimis dhe për pasojë nuk përbënte shkelje. Për tu mbrojtur me sukses, me përdorimin minimal, lpadituri duhet të tregojë se materiali i mbrojtur me të drejtë autori dhe i kopjuar është aq i vogël dhe i parëndësishëm, sa nuk është e mundur të përdorësh testin engjashmërisë thelbësore, të përdorur zakonisht për të provuar shkeljen. *Po ashtu një çështje e njohur është Lancome kundër Kecova*<sup>147</sup>, çështje kjo e

*trajtuar nga gjykatat e civil-law. Rezulton se kompania kozmetike franceze Lancomeshet parfumin ekskluziv « Tresor ». Kompania holandeze Kecova shet një parfum të quajtur Female Tresor me një çmim të konsiderueshëm më të ulët. Lancome është përpjekur dy herë të zhvillojë procese ndaj Kecovës për shkelje të markës tregtare, por pa sukses. Gjykata Supreme konfirmoi se përfundimet e arritura nga Gjykata e Apelit tregonin se të gjitha komponentët e të dy parfumeve u krahasuan dhe rezultoi se Tresor dhe Female Tresor kanë 24 komponentë të përbashkët nga 26. Fakti që jo të gjitha klauzolat e Aktit Holandez të së drejtës së autorit mund të aplikohen direkt mbi aromën, nuk pengon principin, që krijuesi i një arome origjinale mund të kërkojë mbrojtje, sipas së drejtës së autorit për imitim. Gjithashtu edhe vetë fakti se një parfum i përshtatet një tradite apo stili të caktuar, nuk e përjashton atë nga mbrojtja me të drejtë autori. Për më tepër, probabiliteti i të pasurit të 24 komponentëve të përbashkët sipas raportit, do të ishte sikur të fitojë llotarinë çdo ditë për një shekull me rradhë. Ia vlen të përmendet, se në një rast të ngjashëm në Francë, një vendim krejt i ndryshëm u arrit për faktin nëse një parfum mund të mbrohet me të drejtë autori. Gjykata e lartë franceze vendosi, se prodhuesit e parfumeve duhet të cilësohen si artizanë më shumë sesa artistë dhe për pasojë punët e tyre nuk mund të mbrohen sipas së drejtës*

<sup>7</sup> Neni 220 TKE.

<sup>8</sup> Commission of the European Communities v Kingdom of Spain”, Case C-31/04, OJ no. C-171, 09.07.2005, page 3; “Commission of the European Communities v United Kingdom of Great Britain and Northern Ireland”, Case C-88/04, OJ no. C-045, 19.02.2005.

së autorit.

### 3. Përafrimi legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian, për mbrojtjen e të drejtës së autorit.

Shqipëria është shumë e vetëdijshme se zbatimi efikas i të drejtave të pronësisë intelektuale është një element thelbësor për progresin e mëtejshëm socioekonomik si dhe rritjen e nivelit të konkurrueshmërisë së vendit në tregun kombëtar dhe garantimin e një mjedisi konkurrence të drejtë në tregun kombëtar. Ajo, kontribuon në krijimin e kushteve optimale për thithjen e investimeve të huaja në vend si dhe është një gur themeli në procesin e integritetit të tij në Bashkimin Evropian. Strategjia Kombëtare 2010 – 2015 për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale në Shqipëri është pikerisht, një nga gurët e rëndësishëm të rrugës drejt integritetit. Përgatitja e saj është bazuar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013, në analizën e kuadrit ligjor ekzistues si dhe masave administrative dhe institucionale të ndërmarra në vend lidhur me këtë çështje. Përfundimet e strategjisë janë përshtatur me detyrimet që ka Shqipëria lidhur me të drejtat e pronësisë intelektuale në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit dhe integritetit në Bashkimin Evropian<sup>9</sup>, duke identifikuar në këtë mënyrë objektivat dhe masat e nevojshme që duhen marrë nga Shqipëria lidhur me këtë komponent në të ardhmen. Në këtë dokument, “pronësia intelektuale” (PI) nënkupton jo vetëm patentat, dizenet industriale, modelet e përdorimit, markat tregtare, topografinë egjysmëpërcjellësve dhe treguesit gjeografikë, por edhe të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të, megjithëse kjo është trajtuar shpesh si një kategori e veçantë e ligjit.

Sot legjislacioni shqiptar është pothuajse i harmonizuar me Acquis të BE-së dhe siguron një mbrojtje më të mirë të së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të. Forcimin dhe shtimin e kontrollit, monitorimin dhe mekanizmat (mjetet) shtetërorë ndëshkues, si dhe krijimin e “filtrave” për masa me efikasitet për importuesin, eksportuesin, prodhuesin, përdoruesin ose shfrytëzuesin e subjekteve të veprave artistike, kulturore dhe shkencore. Caktimin e detyrave dhe procedurave administrative për çdo institucion shtetëror si dhe rregullimin e bashkëpunimit midis njëri-tjetrit në mënyrë që zinxhiri institucional të jetë funksional dhe efikas. Mbulimin më të gjerë dhe specifikimin e rasteve që përbëjnë kundërvajtje administrative ose penale, shkelje ose vepra penale.

### Përfundime

Instituti i të drejtës së autorit nuk rezultoi të jetë i hershëm as në botë. Fillimisht pronësia intelektuale njihet thjesht si e drejtë morale dhe jo si një e drejtë edhe ekonomike e autorit apo titullarit të pronësisë intelektuale. Ky është një kuadër i përgjithshëm i evolimit botëror historik; por në punim vëmendje e veçantë i është kushtuar statusit të së drejtës së autorit në Bashkimin Evropian dhe legjislacionit të së drejtës së autorit në Shqipëri.

<sup>9</sup> NENI 70 MSA





Iniciativa e 6 vendeve të para europiane, të cilat u ulën në tryezë dhe vendosën krijimin e politikave të përbashkëta në kontinent, u finalizua në vitin 1951 me krijimin e Komunitetit Europian. Një erë e re po frynte në kontinentin e vjetër. Këtij komuniteti iu shtuan edhe shumë shtete të tjera. Në vitin 1992, traktati i Maastrichtit bëri Bashkimin Europian, që sot ka në gjirin e vet 27 shtete anëtare. Parimi i këtij bashkimi është harmonizimi i legjislativave kombëtare të shteteve anëtare në të gjitha degët e së drejtës. Të njëjtën linjë Bashkimi Europian ka ndjekur edhe përfshën e të drejtës së autorit nëpërmjet direktivave. Por ky vendim nuk shtrihet vetëm për shtetet anëtare por edhe për shtetet që synojnë të jenë pjesë e bashkimit. Ndaj këtyre shteteve lind detyrimi i përshtatjes së legjislativave kombëtar me atë të Bashkimit Europian, me anë të transpozimit të *direktivave*.

E drejta e autorit u shndërrua në një të drejtë të njohur në mënyrë të parashkruar nga ligji. Por edhe pse ekziston një kuadër ligjor që duhet ta mbrojë atë, përsëri shohim që kjo e drejtë nuk respektohet, apo akoma më keq nuk njihet fare. Legjislativi nuk është i mjaftueshëm dhe

shumë pak i materializuar në terren. E drejta e autorit është sot një prej të drejtave më të shpërfillura dhe më joekzistuese në rrafsh praktik, si në anën etike dhe financiare, ashtu dhe në atë intelektuale. Përshtatjet, kompilimet, deri plagjiatura e hapur, sundojnë në fushë të botimeve. Gazetat mbushen me artikuj që gjenden gratis në rrjetet multimediale, shpesh duke u botuar dhjetëra herë, jo vetëm pa shpërblim, por edhe pa pëlqimin formal të autorëve. Njihen raste kur autori ka ndryshuar mendim për një studim të vetin të hershëm dhe mund të botonte të reja e kërkimit të tij, por në shtyp botohet ajo që gjendet lirë. Botuesit e të përditshmeve jo vetëm që nuk njohin përgjegjësi për autorësinë e shkrimeve, por, në rastet e ankimeve të rralla i vënë autorët në pozitën e përfituesit - ju është bërë nder e publicitetit përmes botimit!

Për paradoks, rastet e verifikuara të arbitrit të çështjeve të së drejtës së autorit në gjykata shenjojnë sukses kryesisht kur trashëgimtarët, jo vetë autorët, u drejtohen atyre.

## Bibliografia

- Mandro A, "E drejta romake" Shtëpia botuese Aferdita, 1998, Tirane.
- Borchardt.K.D, 2011, ABC e së Drejtës së Bashkimit Europian, Pegi, Tiranë,
- Berne Convention for the Protection of Literary and Artistic Works (Paris 1971), TRIPS-(Trade Related Intellectual Property Rights) on WTO, WIPO-Performances and Phonograms Treaty (WPPT-1996).
- Direktiva 93/83/KE date 27 shtator 1993 "Per koordinimin e rregullave per te drejtën e autorit dhe të drejtave të lidhura me të që zbatohen në transmetimet satëlitore dhe ritransmetimet kablore – Celex nr. 31993L0083/ Fletorja zyrtare 1993L248/15.
- Direktiva 2001/84/KE e Parlamentit Europian dhe Këshillit datë 27 shtator
- 2001 "Per te drejten e rishitjes ne dobi te autorit te nje vepre arti origjinale" – Celex nr. 32001L0084/ Fletorja zyrtare 2001 L 272/32.
- Direktiva 2006/115/KE e Parlamentit Europian dhe Këshillit datë 12 dhjetor 2006 "Per te drejten e qirase dhe huazimit si dhe per disa te drejta qe lidhen me të drejtën e autorit në fushën e pronësisë intelektuale" (version i kodifikuar i 92/100/KEE) – Celex nr. 32006L0115/ Fletorja zyrtare 2006 L 376/28.
- Direktiva 2006/116/KE e Parlamentit Europian dhe Këshillit datë 12 dhjetor 2006 "Per mbrojtjen e te drejtes se autorit dhe te drejta te tjera te lidhura me te" (version i kodifikuar i 93/98/KE) – Celex nr. 32006L0116/ Fletorja zyrtare 2006 L372/12.
- Direktiva 96/9/KE e Parlamentit Europian dhe Këshillit datë 11 mars 1996 "Per mbrojtjen ligjore te bazave te te dhenave" – Celex nr. 31996L0009/ Fletorja zyrtare 1996 L 77/20.
- Direktiva 2009/24/KE e Parlamentit Europian dhe Këshillit datë 23 prill 2009 "Per mbrojtjen ligjore te programeve kompjuterike" – Celex nr. 32009L0024/ Fletorja zyrtare 2009 L 111/16.
- Commission of the European Communities v Kingdom of Spain", Case C-31/04, OJ no.C-171,09.07.2005; "Commission of the European Communities v United Kingdom of Great Britain and Northern Ireland", Case C-88/04, OJ no.C-045, 19.02.2005
- [http://europa.eu/legislation\\_summaries/internal\\_market/businesses/intellectual\\_property/126032\\_fr.html](http://europa.eu/legislation_summaries/internal_market/businesses/intellectual_property/126032_fr.html)
- <http://www.wipo.int/about-ip/en/>